



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULATOR I ENERJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 53, Datë 03.03.2025

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“GREEN ENERGY” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT
TË ENERJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET
PRODHUES 2 MW**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 03.03.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1172/1 prot., datë 28.02.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “GREEN ENERGY” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “GREEN ENERGY” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1172 prot., datë 20.02.2025, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 2 MW, me vendndodhje në fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se:

Përputhshmëria e Aplikimit me Rregulloren:

- Në përputhje me nenin 9, pika 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas gërmave (a, b dhe c), duke plotësuar formularin sipas formatit të përcaktuar në Shtojcën 1, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duke plotësuar të dhënat e subjektit, përfshirë emrin, NUIS-in, adresën, kontaktet dhe administratorin. Gjithashtu, aplikuesi deklaroi se nuk i është hequr apo refuzuar më parë një licencë, angazhohet për zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullave të ERE si dhe ka kryer pagesën e aplikimit më 18.02.2025 sipas Aneksit A.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas gërmave (a, b dhe d). Konkretisht, ai ka depozituar ekstraktin historik të regjistrimit tregtar të vulosur elektronikisht nga QKB, më datë 29.01.2025. Gjithashtu, aplikuesi ka dorëzuar në ERE vërtetimet e gjendjes gjyqësore të vulosura elektronikisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me datë 24.01.2025, për administratorin e shoqërisë dhe më datë 29.01.2025 për vetë shoqërinë, nga të cilat rezulton se si administratori i shoqërisë, ashtu edhe subjekti “GREEN ENERGY” sh.p.k., janë të padënuar.
- Në përputhje me pikën 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas gërmës (c). Aplikuesi ka depozituar në ERE Planin e Biznesit për ndërtimin e impiantit fotovoltaiik 2MW dhe financimi i projektit parashikohet të realizohet 20% nga fondet e ortakut dhe 80% nga një kredi bankare.
- Në përputhje me Pikën 2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike sipas gërmave (b, c, d dhe f). Shoqëria ka depozituar formatin e plotësuar me të dhënat teknike për centralin fotovoltaiik, përfshirë informacionet mbi kapacitetin dhe specifikimet teknike të pajisjeve. Nga ky informacion aplikuesi nuk ka deklaruar vitin e ndërtimit të centralit fotovoltaiik dhe datën e fillimit të operimit, ndërsa jetëgjatësia e pritshme e centralit është 30 vjet.

Paisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera:

- MIE dhe shoqëria “GREEN ENERGY” sh.p.k., kanë nënshkruar Kontratën nr. 7632 rep., nr. 3821 kol., datë 29.12.2023 “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaiike, me kapacitet prodhues 2 MW dhe veprave ndihmëse, në fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga shoqëria “GREEN ENERGY” sh.p.k.”.
- OSSH sh.a. me shkresën nr. 9937/3 prot., datë 25.10.2022 ka miratuar pikën e lidhjes me rrjetin.
- Shoqëria është pajisur me Vendimin për VNM Paraprake, lëshuar më datë 03.11.2022 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për zhvillimin e projektit “IMPIANTI FOTOVOLTAIK 2 MW “GREEN SOLAR PARK SEMAN” (për të cilën nuk ka dokumentuar fillim punimesh brënda periudhës së vlefshmërisë së kësaj VNM).
- Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- **gërma “c”:** Shoqëria duhet të bëjë me dije se cila pjesë e strukturës së saj do të angazhohet me anën teknike në ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike ose, në të kundërt, të bëjë përditësimet e nevojshme në organigramën e saj.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **gërma “a”**: Shoqëria duhet të depozitojë vërtetimin që nuk ka detyrime të pashlyera ndaj organeve tatimore.
- **gërma “b”**: Shoqëria duhet të dokumentojë aftësinë financiare për mbulimin e pjesës së mbetur (prej 20 %) të vlerës së investimit për realizimin e projektit fotovoltaiik.

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

- **gërma “a”**: Shoqëria duhet të plotësojë të dhënat për vitin e ndërtimit të centralit dhe datën e fillimit të operimit.
 - **gërma “e”**: Shoqëria duhet të depozitojë VNM Paraprake të re ose aplikimin përkatës për t’u pajisur me të.
-
- Në lidhje me jetëgjatësinë e pritshme të centralit, shoqëria duhet të depozitojë një dokument teknik (si psh: garancinë përkatëse) për panelet fotovoltaike.
 - Për sa referuar në kontratën e nënshkruar me MIE-n në lidhje me afatet dhe për sa depozituar nga vetë shoqëria (raportime të bëra vetëm në AKBN dhe jo në MIE) vlerësohet që ERE të zhvillojë korrespondencë/seancë dëgjimore me përfaqësues të MIE-s dhe shoqërisë, me qëllim marrjen e qëndrimit të kësaj të fundit në kuadër të përcaktimeve të kontratës së koncensionit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “GREEN ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet prodhues 2 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “GREEN ENERGY” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI